



KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Kuvendi i Komunës së Gjakovës
01 Nr. _____ /2019
Dt.03.06.2019

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12 të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenin 1, Paragrafi 1 të Ligjit nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, në mbledhjen e mbajtur me dt.03.06.2019 pas diskutimit lidhur me pikën e 16 të rendit të ditës: Shpallet Interesi të përgjithshëm për parcelën e cili menaxhohet nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit (AKP) me P-70705037-00074-0 zona kadastrale Qytet Gjakovë në pronësi të P.SH KBI. Ereniku e miratoi këtë:

V e n d i m **Për Shpalljen e interesit publik .**

1. Shpallet Interesi të përgjithshëm për parcelën e cili menaxhohet nga Agjencioni Kosovar i Privatizimit (AKP) me P-70705037-00074-0 zona kadastrale Qytet Gjakovë në pronësi të P.SH KBI. Ereniku .
2. Qëllimi i shpalljes së Interesit përgjithshëm në parcelën e cekur në pikën 1 të këtij vendimi bëhet me qëllim të ndërtimit të fushës së futbollit në lagjen "Dardania".
3. Obligohen Organet e Administratës Komunale që të ndjekin të gjitha procedura sipas legjislacionit në fuqi për shpronësimin e parcelës të cekur me lartë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës .

5. Vendimi iu dërgohet:

- Kryetarit të Komunës së Gjakovës, z. Ardian Gjini
- Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
- Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës.
- Drejtorisë për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit .
- Drejtorisë për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
- Arkivit.

